# DËSHMI ARKIVI

**A-474023**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Përplasja për SHISH-in, Këlliçi “sulmon” Ramën pas konferencës: Nuk mban asnjë përgjegjësi për skandalin, koha e tij ka marrë fund |
| ADRESA | `https://newsbomb.al/politike/perplasja-per-shish-in-kellici-on-ramen-pas-konferences-nuk-mban-as-i402138` |
| BURIMI | newsbomb.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 14:27:42 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 14:23:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b6336b6b6a36cd4dfc3a45d16e45e0b786750f7ea5b7b172a1f89f41a9fff12f` |
| TEKSTI | `e85cc67b9d7206814735286faae9c672fbca9bbf35387284fc03c95415392fcc` |
| PAMJA | `70dc668e11263eaa03a55dc2bba0dbecc4f4f761e7d179ae8c12baf2533536a8` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5b2933529f279195c87f32d7bf830b540e01e51668be64e6653c805805ab7c8a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3dbf5264f26ae921c8f8735760cb378b1b626a14b73f487ffe641eb8f02fca55` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5b2933529f279195c87f32d7bf830b540e01e51668be64e6653c805805ab7c8a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



Politikë

27 Shtator 2026, 16:23

# Përplasja për SHISH-in, Këlliçi "sulmon" Ramën pas konferencës: Nuk mban asnjë përgjegjësi për skandalin, koha e tij ka marrë fund

Shkruar nga **Newsbomb**




**Deputeti demokrat Belind Këlliçi**

Deputeti i Partisë Demokratike, Belind Këlliçi, ka reaguar pak pas konferencës së jashtëzakonshme të kryeministrit Edi Rama, të mbajtur menjëherë pas kthimit të tij nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në fokus të deklaratës së kryeministrit ishte çështja e ish-drejtueses së Shërbimit Informativ të Shtetit, Vlora Hyseni, e cila ndodhet në arrest shtëpie. Rama u shpreh se distancohet nga çështja dhe se Hyseni duhet të përballet vetë me akuzat e drejtësisë. Sa i përket emërimit të saj në krye të SHISH, kryeministri tha se vendimi ishte marrë duke u mbështetur edhe në referencat e marra nga partnerët ndërkombëtarë.

Por qëndrimi i kreut të qeverisë është kundërshtuar nga deputeti demokrat Belind Këlliçi. Në reagimin e tij, ai akuzon Ramën se po përpiqet të shmangë çdo përgjegjësi politike për situatën e krijuar në Shërbimin Informativ të Shtetit.

Këlliçi e cilëson çështjen si një skandal të rëndë dhe ngre pikëpyetje mbi mënyrën se si Vlora Hyseni u promovua dhe u emërua në drejtimin e institucionit të sigurisë. Sipas tij, fakti që Hyseni është përzgjedhur më herët për poste të rëndësishme nuk mund të justifikohet vetëm përmes referencave të partnerëve ndërkombëtarë.

*"Për këtë aferë të pashembullt, Kryeministri tha se nuk ndjen dhe nuk mban asnjë përgjegjësi, edhe pse Vlora Hyseni është promovuar dhe emëruar personalisht nga ai*

## Revista




Abonohu tani dhe lexoje

## Lajmet e fundit



**Aktualitet**
Operacioni shkolla të Pastra/ Kush janë gjithë të arrestuarit e operacionit të djeshëm, zbardhen emrat pas vendosjes në burg nga gjykata (LISTA – EMRAT)



**Aktualitet**
"Le ta hedhin atë bombë mëngjes, drekë dhe darkë", Rama u përgjigjet kundërshtarëve: Ata katër të vrarët në bulevard nuk kanë marrë akoma drejtësi

Zbulo më shumë artikuj

*Sipas tij fajtor për Vlorën, janë referencat e shkëlqyera të partnerëve ndërkombëtarë*", tha Këlliçi ndër të tjera.

**Postimi i plotë:**

*Skandali i rëndë i Shërbimit Sekret, Edi Rama nuk mban asnjë përgjegjësi dhe fajëson SPAK e mediat opozitare!*

*Siç edhe pritej, Edi Rama nuk mbajti sot asnjë përgjegjësi për skandalin e rëndë të Shërbimit Sekret, ku kreu i saj është nën akuzë për përkrahje të autorit të krimit dhe nxjerrje të informacioneve sekrete për llogari të krimit.*

*Për këtë aferë të pashembullt, Kryeministri tha se nuk ndjen dhe nuk mban asnjë përgjegjësi, edhe pse Vlora Hyseni është promovuar dhe emëruar personalisht nga ai. Sipas tij fajtor për Vlorën, janë referencat e shkëlqyera të partnerëve ndërkombëtarë!*

*Edhe pse Vlora Hyseni ishte shërbëtore e koordinatorit të Edi Ramës për bandat, Ergys Agasi. Edi Rama normalizoi sot atë që ka ndodhur, goditjen më të rëndë të sigurisë kombëtare prej abuzimit me pushtetin, dhe quajti faj të rëndë hetimet dhe veprimet e SPAK dhe raportimet e sakta të medias.*

*Ai sulmoi drejtësinë dhe mediat për korrupsionin dhe abuzimin me pushtetin të qeverisë dhe bashkëpunëtorëve të tij.*

*Edi Rama nuk do ta mbajë dot me forcë pushtetin!*

*Ai u bë sot edhe më i urryer nga qytetarët, të cilët e shohin qartë se kush është në krye të këtij sistemi të kalbur, të korruptuar dhe të inkriminuar.*

*Koha e tij ka marrë fund!*

## Sondazh

Poll

## Lexo gjithashtu




E Shtunë 15:49

## Ç'po përgatit Saimir Tahiri?! Ish ministri del përpara kameras: Kam dëgjuar shumë të tregohen për mua, por kam kaq shumë për të thënë







Politikë

Eric Wendt zyrtarisht ambasadori i ri amerikan i Shqipërisë, Begaj: Forcim partneriteti mes SHBA-ve dhe vendit tonë (FOTO)

E Shtunë 15:31 Newsbomb



Politikë

"Protestat, kundër armikut fantazmë!" Rama nga Asambleja e OKB-së: AI të përdoret në të mirën e qytetarëve! U fabrikua pushtimi izraelit i Shqipërisë

E Premte 19:51 Newsbomb




E Premte 19:25 Newsbomb

# Berisha me premtime para elbasanllinjve: Me fitoren e mandatit të parë, do të dyfishojmë pagat dhe pensionet, do heqim taksat e ushqimeve




Politikë

Kryeministri Rama në New York: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, dëshmi e transformimit të Shqipërisë

E Premte 19:17



Politikë

100 apo 15 bashki? Demokratët e socialistët bëjnë lëvizjen e radhës, PD i dërgon draft ligjin Kuvendit, mazhoranca kërkon aprovimin e Peleshit

E Premte 17:12 Newsbomb




E Premte 16:13

# Edi Rama nga New York: Joe Biden e tradhtoi Hashim Thaçin, SHBA nuk bëri më të mirën për të



Politikë

Këshilli i Ministrave firmos ndryshime në drejtimin e institucioneve, ja emërimet dhe lirimet nga detyra (EMRAT)

E Premte 16:02



Politikë

Qëlloi me lugë e shishe të rinjtë protestues, reagon Delina Fico: Po haja qofte dhe po pija birra, s'përmbajta veten kur i përmendën Bledit "gruan"

E Premte 14:44



Politikë

E Premte 14:19

# Këshilli Bashkiak i Tiranës me letër SPAK-ut dhe Burgjeve, kërkon që Erion Veliaj të dalë nga burgu: Na i sillni kryebashkiakun, është e nevojshme



Politikë

Anulohet tenderi 4.59 miliardë lekë për hemodializën në pesë qytete, Agjencia e Prokurimit Publik: Kishte mangësi dhe gabime në dokumente

E Premte 13:23



Politikë

"Vendi ka pësuar dëme të pallogaritshme", ish-ministri Sandër Lleshaj thirrje politikës të marrë masa: Gjëmë e padëgjuar kurrë, qytetarët nuk kanë kujt t'i besojnë më

E Premte 08:36




Politikë




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.